



Informacione për detyrimin shkollor

1. Çfarë do të thotë detyrim shkollor?

Detyrim shkollor do të thotë se fëmijët janë të detyruar të ndjekin një shkollë.

Një fëmijë bëhet i detyruar për të frekuentuar një shkollë në atë vit, në të cilin ai mbush gjashtë vjeç deri më 30 shtator. Detyrimi shkollor zgjat parimisht dhjetë vjet. Fillimisht fëmijët ndjekin shkollën fillore (klasa 1-4) dhe më pas një shkollë që çon më tej (klasa 5-10).

Për të rinjtë pa marrëdhënie të shkollimit profesional detyrimi shkollor zgjat deri në përfundimin e vitit shkollor, në të cilin ata mbushin 18 vjeç.

Për të rinjtë me marrëdhënie të shkollimit profesional detyrimi shkollor zgjat për aq kohë sa të ekzistojë marrëdhënia e shkollimit profesional, e cila ka filluar para moshës 21 vjeç.

Nxënëset dhe nxënësit janë të detyruar të marrin pjesë rregullisht në mësim, por edhe në aktivitete të tjera të detyrueshme shkollore (p.sh. festa të shkollës, ekskursione të klasës, mësim sporti, noti etj.). Përveç kësaj, ata janë të detyruar për bashkëpunim, për përgatitjen e mësimit dhe punën pas mësimit dhe për t'i kryer detyrat e shtëpisë.

Ju si prindër mbani përgjegjësi që fëmija juaj ta frekuentojë shkollën.

Në rast të sëmundjes (dhe nëse fëmija është më i ri sesa 18 vjeç) ju duhet ta njoftoni menjëherë shkollën (jo më vonë sesa në ditën e dytë të shkollës) me gojë ose me shkrim.

Nxënëset dhe nxënësit në moshën madhore mund ta njoftojnë vetë shkollën.

Pas kësaj ka nevojë që ju ta njoftoni shkollën me shkrim, pse fëmija juaj nuk mund ta frekuentonte shkollën. Në rast të sëmundjes së nxënësve ose nxënësit mjafton të shënohet „sëmundja“. Lloji i sëmundjes nuk duhet të shënohet.

Në rast të dyshimit, nëse fëmija juaj nuk e frekuenton shkollën për arsye shëndetësore, shkolla mund të kërkojë nga prindërit respektivisht në rast të nxënësve dhe nxënësve në moshën madhore nga vetë ata që të paraqesin një raport mjekësor.

Pushimet shkollore duhet të respektohen, pra nuk lejohet që ato të shkurtohen ose zgjaten në mënyrë arbitrare. Para dhe pas pushimeve vlen një ndalim parimor i dhënies së lejes. Përjashtime nga kjo mund të bëhen vetëm për arsye të rëndësishme.

Zgjatja e pushimeve ose vajtja ose ardhja më e favorshme në rast të një udhëtimi pushimi nuk janë arsye të rëndësishme.

2. Çfarë ndodh në rast të shkeljes kundër detyrimit shkollor?

Nëse fëmija juaj nuk e frekuenton shkollën, edhe pse ai nuk është i sëmurë dhe as nuk ekziston një arsye tjetër e rëndësishme, juve si prindër (respektivisht nxënësve dhe nxënësve vetë, nëse ata janë në moshën madhore) u kërkohet që t'i justifikoni kohët e mungesës duke e njoftuar arsyen.

Pastaj mësueset dhe mësuesit ndikojnë në mënyrë pedagogjike mbi nxënëset dhe nxënësit (për shembull me anë të këshillimit).

Juve si prindër ju kërkohet që të përkujdeseni që fëmija juaj merr pjesë rregullisht në mësim dhe në aktivitetet e tjera të shkollës. Nxënëseve dhe nxënësve në moshën madhore u tërhiqet vëmendja për detyrimin për ta frekuentuar shkollën. Përveç kësaj, jepet udhëzimi që ekziston mundësia e sjelljes me detyrim të nxënëseve dhe nxënësve në shkollë nëpërmjet zyrës së rendit ose policisë respektivisht mund të iniciohet një procedurë kundërvajtjeje.

Nëse niset një procedurë kundërvajtjeje, prindërve respektivisht nxënëseve ose nxënësve brenda 14 ditëve u jepet mundësia të mbajnë qëndrim në kuadrin e një dëgjimi formal. Nëse plotësohen kushtet për një gjobë, mund të shqiptohet një gjobë deri në 1000 euro.

Një gjobë që nuk është paguar, në rast të të rriturve inkasohet fillimisht në kuadrin e përmbarimit. Me këtë krijohen shpenzime të tjera (taksa paralajmërimi, taksa për përmbaruesin). Nëse përmbarimi mbetet i pasuksesshëm, gjykata mund ta urdhërojë masën shtrënguese me burgim. Në rast të të rinjve dhe adoleshentëve, në vend të pagesës së gjobës mund të kërkohet të kryhen orë pune. Këto mund të urdhërohen nga gjykata. Në rast të mosplotësimit të detyrimit për të punuar mund të kërkohet arrest rinor.

Nëse ju jeni të pasigurt ose keni pyetje, flisni me shkollën.

Informacione të tjera për temën e detyrimit shkollor janë në faqen e internetit të qeverisë së qarkut Münster (www.brms.nrw.de/go/schulpflicht).